



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 31001-00523-00-2014 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 00-2021- 1825 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol SADUSHI	- Kryesues
Asim VOKSHI	- Anëtar
Sokol BINAJ	- Anëtar

më datë 15.11.2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 523/2014 që u përket palëve:

PADITËS: Mimoza Margjeka

I PADITUR: Këshilli i Lartë Gjyqësor

OBJEKTI: Anulimin e vendimit nr. 299/4 datë 30.11.2012 të KLD së me të cilin është vendosur: Dhënia e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim" ndaj znj. Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 33, 36 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Asim Vokshi, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga fashikulli i gjykimit rezulton se pala paditëse Mimoza Margjeka ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Këshillit të Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD), pas verifikimeve të kryera i ka përcjellë për kompetencë vlerësimi Ministrin të Drejtësisë, dy relacione lidhur me mundësinë e procedimit disiplinor të gjyqtares Mimoza Margjeka.

2. KLD ka realizuar një inspektim me objekt verifikimin e respektimit të disiplinës në punë të gjyqtareve, për periudhën kohore 01.01.2009-31.12.2009. Sipas raportit të KLD rezulton se gjyqtarja Mimoza Margjeka, gjatë vitit 2009, periudhë për të cilën është kryer inspektimi, ka

ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Gjyqtarja ka realizuar hyrje e dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke munguar në 3 (tre) ditë pune. Rezulton se në këto data pala paditëse nuk kishte planifikuar seanca gjyqësore dhe nuk rezulton të ketë kërkuar leje kryetarit të gjykatës. Gjithashtu, rezulton se pala paditëse ka hyrë nga jashtë shtetit në datën 23.12.2009, por meqenëse nuk rezulton ora e daljes nuk mund të konkludohet për mungesa në detyrë.

3. Drejtorja se Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, në bazë të urdhrin nr. 58, datë 08.02.2012, të Ministrit të Drejtësisë, "Për ushtrim inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat", të ndryshuar, ka ushtruar inspektim nga data 13.02.2012 deri më datë 01.03.2012, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve procedurale, në çështjet gjyqësore me objekt kundërshtim të veprimeve përmbarimore, sigurim padie.

4. Rezulton se nga kontrolli ushtruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë inspektuar dosjet e regjistruara për periudhën 01.11.2011- 10.02.2012, nga të cilat 2 çështje janë gjykuar nga gjyqtarja Mimoza Margjeka dhe konkretisht çështja civile nr. 21274-04506-11-2011 dhe çështja me nr. 21274-04561-11-2011. Përsa përket çështjes civile nr. 21274-04506-11-2011 depozituar në gjykatë me 01.12.2011 me objekt kundërshtim të veprimeve përmbarimore për dorëzim të sendeve të luajtshme, sigurim padie duke pezulluar ekzekutimin, është konkluduar se deri në kohën inspektimit gjykimi ka zgjatur më shumë se 3 muaj dhe ende nuk ka përfunduar.

5. Për sa i përket çështjes civile nr. 21274-04561-11-2011 e cila është depozituar në gjykatë me datë 02.12.2011 me objekt kundërshtim të veprimeve përmbarimore dhe pezullim ekzekutimit rezulton se çështja ka përfunduar se gjykuari në datën 01.06.2012, me vendim pushimi. Nga ana palës së paditur është konkluduar se vendimi për sigurimin padisë është dorëzuar në sekretari me datë 23.01.2012, mbas 38 ditëve nga shpallja vendimit, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 209 dhe 443 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Nga ana inspektorëve në raportin ekspertimit janë identifikuar si shkelje të palës paditëse mosrespektimi i afatet ligjore për shqyrtimin padisë objekt gjykimi dhe zvarritja gjykimi çështjes, duke dëmtuar interesat e palëve, janë shkelur afatet kohore të arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit të pezullimit, duke shkaktuar zvarritje për realizimin qëllimit për të cilën ky vendim është nxjerrë.

7. Sa më sipër, me shkresën nr. 2334 prot., datë 20.03.2012 Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar KLD fillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarës Mimoza Margjeka duke kërkuar si masë disiplinore "Vërejtje". Me shkresën nr. 58/2 prot., datë 01.10.2012 Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar KLD fillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarës Mimoza Margjeka duke kërkuar si masë disiplinore "Shkarkim nga detyra". Të dyja kërkesat janë bashkuar në një dhe janë gjykuar nga ana e KLD-së në mbledhjen e datës 15.11.2012.

8. KLD me vendimin nr. 299/4 datë 30.11.2012, ka vendosur: *"1. Pranimin e kërkesës të Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Mimoza Margjeka. 2. Dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim" ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Mimoza Margjeka."*

9. KLD ka vlerësuar se janë evidentuar probleme që lidhen me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutive me objekt kundërshtim veprimeve përmbarimore, sigurim padie. Ekzekutimi i titujve ekzekutive kërkon shpejtësi dhe efektivitet brenda standardeve të procesit të rregullt ligjor, me qëllim që ekzekutimi të jetë brenda një afati të arsyeshëm për vetë natyrën e gjykimit. Për këtë shkak neni 610 i Kodit të Procedurës Civile i ka disiplinuar veprimet procedurale brenda afateve të shpejta, 5 ditë për paraqitjen e ankimit në gjykatë dhe 20 ditë për shqyrtimin e ankimit nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët. Afati 20 ditor, i cili është afat gjyqësor, është i detyrueshëm për gjykatën,

ndonëse nuk shkakton dekadencë të të drejtave të palëve. Megjithatë, respektimi i tij paraqet rëndësi për të drejtat e palëve, sepse çdo vonesë i dëmton ato. Këto lloj padish mbartin në vetvete cenimin e të drejtave të palëve si rezultat i mosekzekutimit të kontratave të kredisë bankare, të konsiderueshme dhe shkaktimit të dëmeve të pallogaritshme që vjen nga zvarritja e gjykimit palëve të paditura, si rezultat i moszbatimit të urdhrave të ekzekutimit dhe mospagimit të kësteve të kredive bankare nga kredimarrësit.

10. Duke mos qenë dakord me sa më sipër, paditësja Mimoza Margjeka i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë objekt gjykimi.

11. **Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 53 datë 14.06.2013, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Anulimin e vendimit nr. 299/4 datë 30.11.2012 të KLD-së me të cilin është vendosur: Dhënia e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj Znj. Mimoza Margjeka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”*.

12. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se në lidhje me gjetjen e parë për mungesën në detyrë për tre ditë të gjyqtarës Mimoza Margjeka, pala paditëse ka paraqitur raport mjekësor. Nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë janë bërë verifikimet pranë Qendrës Shëndetësore Bajram Curri në lidhje me ekzistencën e raportit mjekoligjor. Ka rezultuar se raporti mjekësor i paraqitur nga paditësja ishte i regjistruar në regjistrat e kësaj qendre me nr. 2816 datë 28.07.2009. Pala e paditur nuk kanë sjellë asnjë provë apo rrethanë që të vejë në dyshim ekzistencën e saj apo të dyshohej për fakte të rremë apo që kjo provë të jetë goditur për falsitet. Mbi këtë bazë dhe në këto rrethana vendimmarrja e KLD për këtë shkak procedimi nuk është e drejtë dhe e mbështetur dhe si e tillë duhet rrëzuar.

13. Gjykata e Apelit çmon se në lidhje me dy çështje objekt procedimi dhe konkretisht në lidhje me çështjen civile nr. 21274-04506-11-2011 me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore rezulton se ka konfondime në dispozita ligjore të cilave i referohet pala e paditur. Pala e paditur ngatërron institutin e sigurimit të padisë sipas kërkesave të nenit 202, 203 e vijues të Kodit të Procedurës Civile me institutin e pezullimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore sipas kërkesave të nenit 610, 611, dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo për faktin se sigurimi i padisë merret si në rastin e ngritjes së padisë së themelit ose përpara ngritjes së padisë ndërsa në rastin e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore padia e themelit është një padi me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve përmbartimore shih kërkesat e nenit 204 të Kodi të Procedurës Civile dhe nenit 610. Nëse i referohemi vendimit me nr. 299/4 datë 30.11.2012 të KLD, rezulton se KLD i ka hyrë vlerësimit të themelit të çështjes objekt gjykimi. Ky qëndrim bie ndesh me vendimin nr. 11 datë 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese, i cili trajton rastet e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve sipas nenit 147 të Kushtetutës. Rezulton se KLD apo çdo organ tjetër nuk mund të kontrollojë vendimet jashtë rrugës gjyqësore dhe masat ndaj gjyqtarëve merren kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje që diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin gjyqësor. Nga ana e palës paditur nuk janë sjellë prova dhe fakte të cilat provojnë se këto vendime të jenë shoqëruar me akte dhe sjelle që të diskretitojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe që të cenojnë në përgjithësi autoritetin gjyqësor.

14. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur KLD, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 53 datë 14.06.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në rekurs pala e paditur ka pretenduar ndër të tjera se:

- Gjykimi është zhvilluar me shkelje të rënda procedurale pasi nuk janë marrë prova vendimtare për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjykata ka qenë e njëanshme dhe ka mbajtur kur shprehet se nga akti i inspektimit dhe nga vendimmarrja e KLD, nuk është hetuar dhe ndarë kur fillon dhe mbaron përgjegjësia e gjyqtarit ku fillon dhe mbaron përgjegjësia e sekretares gjyqësore dhe ku fillon dhe mbaron përgjegjësia e administratës.

- Përgjegjësia për respektimin e afateve ligjore rëndon mbi gjyqtarin, i cili ka detyrimin të urdhërojë, kontrollojë dhe monitorojë sekretarin gjyqësor e në rast se evidenton prej tij veprime, që pengojnë procesin gjyqësor, të raportojë këtë sjellje e të kërkojë marrjen e masave prej tij. Edhe sikur për një moment të mendonim se sekretarja nuk ka kryer detyrën e saj, si pretendon gjyqtarja, kjo nuk e përjashton gjyqtaren nga përgjegjësia.
- Neni 610 i Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur afat 20 ditor për shqyrtimin e ankimit. Qëllimi i ligjit në caktimin e afatit 20 ditor për përfundimin e këtyre gjykimeve ka lidhje me natyrën urgjente që ato kanë sepse sjellin pasoja në sigurinë juridike, venë në dyshim formën e prerë të vendimeve. Pra, ka afat ligjor për shqyrtimin e kësaj çështje dhe nuk ndodhemi përpara kritereve të përcaktuara nga KLD për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Çdo gjykim tej këtij afati është shkelje e kësaj dispozite procedurale. që ka karakter urdhërues me pasoje përgjegjësive disiplinore të gjyqtarit dhe që cenon të drejtat e shtetasve që i janë drejtuar gjykatës, të cilët nuk e marrin shërbimin prej saj në kohën e përcaktuar në ligj.
- Pretendimi se mungesat në punë në datat 29, 30 dhe 31 korrik 2009, kanë qenë të justifikuar me raport mjekësor, është i padrejtë. Kjo për shkak se gjyqtarja nuk ka marrë leje, as nga Kryetari i Gjykatës dhe as nga KLD. Në 2 deklaratimet që ka bërë para Inspektorëve të KLD të cilat janë marrë më shkrim gjyqtarja ka deklaruar se ka ikur jashtë shtetit për arsye familjare, dhe nuk ka qenë e sëmure. Gjithashtu gjyqtarja nuk e ka paraqitur raportin mjekësor në gjykatë, për të justifikuar mungesën, ndërkohë që nga Kryetari i Gjykatës dhe KLD, nuk ka marrë leje. Paraqitja e raportit pas fillimit të procedimit disiplinor nga ana e Ministrit të Drejtësisë, nuk ka asnjë vlerë, për të justifikuar mungesën pa arsye.

II. Vlerësimi i Kolegjit

15. Paraprakisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) çmon të nevojshme të theksojë se, për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural pasi pala e paditur ka ushtruar rekursin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, është i detyruar që t'i referohet kësaj situate të re ligjore. Ndryshimet që ka pësuar legjislacioni procedural, konkretisht ligji nr. 49, datë 03.05.2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, si dhe Kodi i Procedurës Civile, të cilat kanë hyrë në fuqi në 29.05.2021, janë thelbësore për rregullat që duhet të ndiqen gjatë procedurës së gjykimit që zhvillon ky Kolegji. Konkretisht në nenin 9 të ligjit nr. 49/2021 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, është parashikuar se *“Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.”*. Pra, rregullat e reja që parashikohen për zhvillimin e procedurës së gjykimit nga Kolegji janë të zbatueshme edhe për rastin në shqyrtim.

16. Kolegji konstaton se këto ndryshime ligjore kanë ofruar mjete të përshtatshme procedurale, në funksion të efikasitës së gjykimit në Gjykatën e Lartë, të cilat kanë zgjeruar kufijtë e vendimmarrjes në dhomë këshillimi, si dhe kanë qartësuar rastet e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore. Në këtë drejtim, vlerësohet të theksohet se ligji nr. 49/2021 ka rikthyer autoritetin e dhomës së këshillimit për vendimmarrje në themel të mosmarrëveshjes, ashtu sikurse parashikohej në nenin 63 të ligjit nr. 49/2012, i pandryshuar. Ripozicionimi i ritit kameral të gjykimit, nxjerr në pah parimet e gjykimit administrativ, i cili karakterizohet nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit mbi bazë aktesh dhe dokumentesh për të konkluduar mbi shkaqet e

rekursit me një vendim përfundimtar (neni 61, pika 1 i ligjit nr. 49/2012). Pikërisht, parashikimi ligjor se *“procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera”*, detyron Kolegjin të zbatojë rregullat e reja të gjykimit dhe, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me ritin e gjykimit në dhomë këshillimi të çështjeve gjyqësore.

17. Konkretisht, në çështjet gjyqësore, për të cilat me vendim të ndërmjetëm është vendosur kalimi në seancë gjyqësore, Kolegji ka të drejtë të vlerësojë, rast pas rasti, shkakun e një vendimmarrje të tillë nga trupa gjyqësore e mëparshme, për të konkluduar nëse është e nevojshme të dëgjohen palët apo nëse çështja mund të shqyrtohet edhe mbi bazë dokumentesh. Në një eventualitet të tillë, sipas nenit 171/b të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 62 të Ligjit nr. 49/2012, Kolegji mund të revokojë këtë vendim të ndërmjetëm për të vijuar me gjykimin në dhomë këshillimi, në kushtet kur shkaqet se përse është marrë ky vendim kanë rënë ligjërisht. Mbi këtë bazë, referuar parashikimeve në ligjin nr 49/2012, si edhe rregullave që përcaktohen në legjislacionin procedural mbi revokimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, Kolegji vlerëson se shqyrtimi i çështjes konkrete mund të bëhet në dhomë këshillimi. Në respektim të rregullave që kërkon zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor dhe për t’iu dhënë mundësi palëve për të realizuar mbrojtjen e tyre, mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, Kolegji ka gjithashtu detyrimin për të bërë njoftimin e tyre për të depozituar në një kohë sa më të shpejtë parashtrimet me shkrim, me qëllim zhvillimin e një gjykimi kontradiktor.

18. Siç rezulton edhe nga aktet që ndodhen në dosje, rekursi i palës së paditur është paraqitur brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443/2 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, rekursi i është komunikuar palës paditëse, e cila nuk ka paraqitur kundërrkurs. Mbi këtë bazë, Kolegji Administrativ me vendimin e datës 16.11.2016 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore.

19. Në vijim të argumenteve të sipërpërmendura, pasi është njohur me rrethanat faktike të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, në datën 04.10.2021, Kolegji ka vlerësuar se janë kushtet për vijimin e gjykimit në dhomë këshillimi dhe në mbështetje të nenit 171/b, paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile ka revokuar, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore. Me marrjen e këtij vendimi, është realizuar njëkohësisht edhe njoftimi i palëve, me qëllim dhënien e mundësisë për parashtrimin me shkrim të pretendimeve të tyre, përpara zhvillimit të seancës në dhomën e këshillimit.

20. Kolegji konstaton se pas njoftimit për palët të vendimit të revokimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, për të cilin rezulton të kenë marrë dijeni rregullisht, palët ndërgjyqëse nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim.

21. Nga aktet bashkëlidhur dosjes objekt gjykimi rezulton se rekursi i palës së paditur nuk ngre shkaqe të bazuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënin të cenueshëm vendimin nr. 53 datë 14.06.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo dispozitë, para datës 05.05.2017 parashikonte ndër të tjera se: *“Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit dhe gjykata administrative e shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit.*

22. Në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë përfshihen vetëm rastet rigorozisht të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit, si dhe me shkeljet e rënda të normave procedurale apo shkelje procedurale që kanë

ndikuar në dhënien e vendimit. Në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimit, objektit dhe shkakut të padisë, pretendimeve e prapësimeve të palëve, të vendimit të gjykatës së apelit, si dhe shkaqeve të rekursit, vlerësohet se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykata është rrjedhojë e interpretimit të drejtë të kërkesave të ligjit material dhe procedural.

23. Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit Tiranë ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes (neni 14 i Kodit të Procedurës Civile). Ajo ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të. Konkluzioni i gjykatës së apelit është rrjedhojë e një analize tërësore dhe objektive të provave dhe ligjit të zbatueshëm në rastin objekt gjykimi (neni 126 i Kodit të Procedurës Civile). Pretendimet e palës së paditur janë marrë në shqyrtim nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe janë analizuar në përputhje me parashikimet e nenit 32 dhe 33 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që përcaktojnë shkeljet disiplinore dhe llojet e masave disiplinore. Në rastin objekt gjykimi provat e administruara në procesin administrative nuk vërtetojnë ekzistencën e shkeljeve që të legjitimojnë marrjen e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.

24. Në rastin objekt gjykimi pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur KLD që ngrenë çështje të vlerësimit të provave të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 Kolegji vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

25. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet vendosur mospranimi i rekursit të palës së paditur kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi vendimi është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 63 shkronja (a) të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (*i ndryshuar*),

VENDOSI:

Mospranimin e rekursit të palës së paditur Këshillit të Lartë Gjyqësor kundër vendimit nr. 53 datë 14.06.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Tiranë, më 15.11.2021

ANËTAR

Sokol BINAJ

ANËTAR

Asim VOKSHI

KRYESUES

Sokol SADUSHI

Vërtetohet njësia me origjinalin P.Z. Adm. Gjyq

D.D